REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 305, Datë 26.10.2026

MBI

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT DHE PEZULLIMIT TË STATUSIT TË KOMUNITETEVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; nenit 21, pika 6, të ligjit nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*"; Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.06.2026 "*Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme*", si dhe nenit 15 të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2559/15 prot., datë 22.10.2026, të Grupit të Punës, të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, "*Mbi miratimin e rregullores "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme*",

Konstatoi se:

- Në zbatim të ligjit nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*", është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.06.2026, "*Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme*", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 161, datë 28.07.2026. Kreu VI i këtij udhëzimi parashikon se krijimi dhe administrimi i Regjistrit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme realizohet nga ERE brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e udhëzimit. Brenda të njëjtit afat, ERE miraton rregullat për regjistrimin dhe pezullimin e KER-ve, përfshirë pagesën e regjistrimit.
- Me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, është ngritur Grupi i Punës, në objektin e punës së të cilit përfshihet, ndër të tjera, hartimi dhe ndjekja e procedurës së miratimit të akteve rregullatore në kompetencë të ERE-s, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e klientëve fundorë, klientëve aktivë dhe komuniteteve të energjisë. Në vijim të punës së kryer, Grupi i Punës hartoi projekt-rregulloren "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme", e cila përcakton procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesave për regjistrim, administrimin dhe përditësimin e regjistrit, detyrimet për njoftimin e ndryshimeve, si dhe procedurat për pezullimin dhe rikthimin e statusit aktiv të KER-ve.

- Me vendimin nr. 268, datë 11.09.2026, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme".
- Në zbatim të vendimit të sipërcituar dhe të "Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020, projekt-rregullorja u publikua në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në rubrikën "Konsultime", më datë 14.09.2026, me qëllim marrjen e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara. Gjithashtu, me shkresën nr. 2559/4 prot., datë 15.09.2026, ERE u përcolli ftesë për konsultim dhe paraqitje komentesh mbi projekt-rregulloren palëve të interesuara, përkatësisht: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Autoritetit të Konkurrencës (AK), Avokatit të Popullit, Shoqatës "Konsumatori në Fokus", FIAA Albania, Shoqatës së Prodhuesve të Energjisë së Rinovueshme (AREA), Qendrës ALERT dhe Qendrës "Konsumatori Shqiptar". Nëpërmjet kësaj shkrese, palët u njohën me fillimin e procedurës dhe u ftuan të paraqesin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre mbi projekt-rregulloren brenda 20 (njëzet) ditëve nga publikimi i njoftimit për konsultim. Paralelisht, me shkresën nr. 2559/3 prot., datë 15.09.2026, ERE përcolli njoftimin për hapjen e konsultimit publik pranë gazetave "Panorama" dhe "Tema", me qëllim informimin e publikut dhe sigurimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të palëve të interesuara në proces.
- Në kuadër të procesit të konsultimit publik, pranë ERE-s janë administruar qëndrimet dhe komentet e Autoritetit të Konkurrencës dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.. Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 790/2 prot., datë 07.10.2026, në përgjigje të shkresës së ERE-s nr. 2559/4 prot., datë 15.09.2026, ka vlerësuar se miratimi i rregullores nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, "*Për mbrojtjen e konkurrencës*". Nga qëndrimi i përcjellë nuk rezultojnë propozime konkrete për ndryshimin ose plotësimin e dispozitave të projekt-rregullores. Ndërsa OST sh.a., nëpërmjet shkresës së administruar në ERE me nr. 2599/10 prot., datë 14.10.2026, ka paraqitur komentet dhe propozimet e saj mbi projekt-rregulloren, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Grupi i Punës.
- Në vijim të shqyrtimit të komenteve të OST sh.a., është pranuar pjesërisht propozimi për nenin 3, duke shtuar pikën 4, me qëllim saktësimin e referencave ligjore për termat dhe përkufizimet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë akt. Gjithashtu, është pranuar propozimi për plotësimin e nenit 4, duke shtuar pas pikës 2, pikat 3 dhe 4, sipas formulimit të propozuar nga OST sh.a., me qëllim qartësimin e dallimit ndërmjet regjistrimit të KER-it dhe procedurave të veçanta për autorizimin, lidhjen, aksesin dhe përdorimin e rrjetit.
- Është pranuar propozimi për saktësimin e shkronjave "dh" dhe "e", të pikës 3, të nenit 5, në mënyrë që përshkrimi i centralit prodhues, pajisjeve dhe të dhënave mbi kapacitetin e instaluar dhe vendndodhjen e impianteve të paraqiten veçmas për çdo njësi përbërëse të KER-it. Gjithashtu, është pranuar pjesërisht propozimi për nenin 6, duke plotësuar gërmën "b" me

mundësinë e paraqitjes së marrëveshjes paraprake me operatorin përkatës të sistemit, për rastet kur KER-i përfshin njësi prodhuese ose instalime të planifikuara, për të cilat marrëveshja përfundimtare për përdorimin e rrjetit nuk është lidhur ende në momentin e aplikimit për regjistrim.

- Është pranuar propozimi i OST sh.a. për rishikimin e afateve të përcaktuara në nenin 7 të projekt-rregullores. Në pikën 1, afati për shqyrtimin e dokumentacionit nga ERE ndryshohet nga 10 (dhjetë) në 20 (njëzet) ditë pune, ndërsa në pikën 3, afati për paraqitjen e dokumentacionit ose informacionit plotësues nga aplikanti ndryshohet nga 20 (njëzet) në 10 (dhjetë) ditë pune. Këto ndryshime synojnë harmonizimin e afateve procedurale me përcaktimet e Kreut II, pikat 13 dhe 14, të Udhëzimit nr. 4, datë 29.06.2026.
- Janë pranuar propozimet për riformulimin e gërmës "d", të pikës 2, të nenit 9, me qëllim evidentimin në Regjistër të të dhënave mbi njësitë prodhuese dhe depozituese të përfshira në KER, kapacitetin e secilës prej tyre, si dhe kapacitetin total të KER-it, si dhe për riformulimin e gërmës "ç", të pikës 1, të nenit 10, me qëllim qartësimin e detyrimit të KER-it për të njoftuar ERE-n për ndryshimet që lidhen me njësitë prodhuese të përfshira në KER dhe kapacitetet e tyre.
- Në lidhje me nenin 14, është pranuar propozimi i OST sh.a. për shtimin e pikës 2, që parashikon njoftimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe, sipas rastit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për vendimin e pezullimit të statusit të KER-it, si dhe në rastin e rikthimit të statusit aktiv. Gjithashtu, propozimi për ndryshimin e gërmës "b", të pikës 1, të nenit 14, është reflektuar në nenin 13 të projekt-rregullores.
- Është pranuar propozimi i OST sh.a. për plotësimin e nenit 18, duke përfshirë në gërmën "c" edhe shkëmbimin e informacionit me operatorët e sistemit dhe subjektet e tjera kompetente, për çështjet që lidhen me lidhjen dhe përdorimin e rrjetit, matjen, operimin dhe respektimin e kodeve të rrjetit, në funksion të ushtrimit të kontrollit dhe monitorimit nga ERE.
- Propozimet e tjera të OST sh.a., për të cilat nuk është vlerësuar i nevojshëm reflektimi në projekt-rregullore, lidhen me plotësimin e nenit 1, shtimin e dispozitave të veçanta në nenet 9 dhe 10, riformulimin e nenit 12, plotësimet e propozuara në nenet 14, 15, 16 dhe 19, si dhe shtimin e një dispozite të përgjithshme lidhur me kuadrin ekzistues të rrjetit. Arsyetimet përkatëse janë paraqitur në vlerësimet e Grupit të Punës për secilin koment.
- Në përfundim të procesit të konsultimit publik dhe shqyrtimit të komenteve të paraqitura nga palët e interesuara, Grupi i Punës vlerëson se projekt-rregullorja "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme", me ndryshimet dhe plotësimet e reflektuara, vlerësohet se është në përputhje me qëllimin dhe kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 29.06.2026, "Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme".
- Komentet dhe propozimet e paraqitura gjatë konsultimit publik janë shqyrtuar dhe vlerësuar. Në projekt-rregullore janë reflektuar ato propozime që kontribuojnë në qartësimin e dispozitave dhe përmirësimin e procedurave të regjistrimit, administrimit të Regjistrit, pezullimit dhe monitorimit të KER-ve, duke ruajtur objektin dhe fushën e zbatimit të këtij akti.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme". (bashkëlidhur këtij vendimi)

2. Grupi i punës të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe palët e interesit, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 305, Datë 26.10.2026

RREGULLORE

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT DHE PEZULLIMIT TË STATUSIT TË KOMUNITETEVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat që zbatohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për:
   a) paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për regjistrimin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme (KER);
   b) kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet që kërkojnë regjistrimin si KER;
   c) krijimin, administrimin dhe përditësimin e Regjistrit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme;
   ç) kushtet dhe procedurën për pezullimin dhe rikthimin e statusit aktiv të një KER;
   d) detyrimet e KER-ve lidhur me ruajtjen e të dhënave të regjistruara dhe bashkëpunimin me ERE gjatë ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me:

a) ligjin nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”;

b) nenin 21 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

c) Kreun VI, pika 1, të Udhëzimit nr. 4, datë 29.06.2026, “Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme”;

ç) aktet e tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Komunitet i Energjisë së Rinovueshme (KER)"** është subjekti juridik i krijuar dhe që vepron në përputhje me kuadrin ligjor për energjinë nga burimet e rinovueshme, mbi bazën e pjesëmarrjes së hapur dhe vullnetare të anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e aktiviteteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. **"Regjistri i Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme"** është regjistri elektronik i administruar nga ERE, në të cilin evidentohen KER-të e regjistruara dhe të dhënat përkatëse të tyre.
3. **"Pezullim"** është masa administrative e marrë nga ERE, nëpërmjet së cilës një KER humbet përkohësisht statusin aktiv në regjistër deri në eliminimin e shkaqeve që kanë sjellë këtë masë.
4. Për termat dhe përkufizimet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë rregullore, zbatohen përkufizimet e parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi, veçanërisht në ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe në Udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.06.2026, "Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme."

Neni 4
Detyrimi për regjistrim

1. Çdo Komunitet i Energjisë së Rinovueshme që kërkon të ushtrojë të drejtat dhe aktivitetet e parashikuara nga kuadri ligjor për KER-të, duhet të regjistrohet pranë ERE.
2. Regjistrimi në ERE është procedurë administrative e veçantë me karakter evidentues dhe administrativ dhe nuk përbën licencim apo autorizim për ushtrimin e aktiviteteve që sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë licencë ose autorizim, përfshirë prodhimin, furnizimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike.
3. Regjistrimi i KER-it nuk përbën dhe nuk zëvendëson miratimin ose autorizimin për zhvillimin dhe ndërtimin e njësive prodhuese të përfshira në të, miratimin e lidhjes në rrjet, rezervimin ose garantimin e kapacitetit të rrjetit, përcaktimin e operatorit kompetent të sistemit, nivelit të tensionit, pikës apo kapacitetit të lidhjes dhe nuk krijon, në vetvete, të drejtë ose garanci për lidhjen e KER-it apo të njësive prodhuese të përfshira në të në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes.
4. Autorizimi dhe zhvillimi i njësive prodhuese, si dhe lidhja, aksesi dhe përdorimi i rrjetit, i nënshtrohen procedurave, kushteve dhe miratimeve përkatëse të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet rregullatore përkatëse.

Neni 5
Paraqitja e kërkesës për regjistrim

1. Kërkesa për regjistrim paraqitet pranë ERE nga përfaqësuesi ligjor i KER.
2. Kërkesa për regjistrimin e KER-it paraqitet sipas Formularit të Regjistrimit, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë përbërëse e saj.
3. Formulari plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i KER-it dhe shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në Udhëzimin nr. 4, datë 29.06.2026 "Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme" dhe përmban:
   a) emërtimin dhe formën juridike të KER;
   b) numrin unik të identifikimit;
   c) adresën e selisë dhe të dhënat e kontaktit;
   ç) përshkrimin e aktivitetit, përfshirë dhe pa u limituar në format dhe mënyrat e prodhimit, konsumit, depozitimit, ndarjes, shitjes së energjisë së rinovueshme dhe ofrimit të agregimit;
   d) listën e anëtarëve themelues;
   dh) përshkrimin e centralit prodhues dhe të pajisjeve të instaluara dhe/ose të planifikuara, për çdo njësi prodhuese përbërëse të KER-it;
   e) kapacitetin e instaluar dhe vendndodhjen e impianteve, për çdo njësi prodhuese përbërëse të KER-it;
   ë) deklaratën e përputhshmërisë me kriteret dhe kërkesat ligjore për funksionimin e KER;
   f) deklaratën e anëtarëve të KER-it, sipas modelit të përcaktuar në Aneksin 2, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6
Dokumentacioni shoqërues

Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) statutin e shoqërisë dhe aktin e themelimit;
b) marrëveshjen me operatorin e sistemit për përdorimin e rrjetit ose marrëveshjen paraprake;
c) përshkrimin e aktivitetit, përfshirë dhe pa u limituar në format dhe mënyrat e prodhimit, konsumit, depozitimit, ndarjes, shitjes së energjisë së rinovueshme dhe ofrimit të agregimit;
ç) përshkrimin e centralit prodhues dhe të pajisjeve dhe instalimeve të planifikuara;
d) hartën e vendndodhjes së pajisjeve dhe instalimeve të planifikuara;
dh) komunitetet e energjisë së rinovueshme me kapacitet të instaluar mbi 100 kW duhet të paraqesin gjithashtu planin e biznesit me vlerësim teknik dhe financiar për pesë vitet e para;

e) pagesën e regjistrimit, e cila miratohet nga ERE në përputhje me parimin e mos-pengimit të krijimit të Komuniteteve të energjisë së rinovueshme;

ë) datën e parashikuar të vënies në operim;

f) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së regjistrimit, sipas pagesës së miratuar nga ERE.

Neni 7
Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim

1. ERE shqyrton përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur brenda 20 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës.
2. Në rast se dokumentacioni i paraqitur rezulton i paplotë ose kërkon sqarime shtesë, ERE njofton aplikantin për plotësimin e mangësive të konstatuara.
3. Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin ose informacionin plotësues brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.
4. Në përfundim të afatit të përcaktuar, ERE shprehet për miratimin / refuzimin e kërkesës.

Neni 8
Vendimi për regjistrim

1. Pas përfundimit të procesit të verifikimit, ERE vendos:
   a) regjistrimin e KER në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme; ose
   b) refuzimin e kërkesës për regjistrim, duke paraqitur arsyetimin përkatës ligjor dhe faktik.

   Në rast të miratimit të kërkesës, ERE, brenda 3 (tre) ditëve pune, pajis KER-in me numrin e regjistrimit dhe e pasqyron atë në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
2. Vendimi për regjistrimin publikohet në Regjistrin elektronik të KER-ve të administruar nga ERE.
3. KER konsiderohet i regjistruar me regjistrimin e tij në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, pas marrjes së vendimit të Bordit të ERE-së për miratimin e kërkesës.
4. Çdo KER i regjistruar pajiset me një numër unik regjistrimi, i cili nuk i caktohet një KER-i tjetër.

Neni 9
Përmbajtja e Regjistrit të KER-ve

1. ERE krijon dhe administron Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, në formë elektronike.
2. Regjistri i KER-ve përmban të paktën:
   a) emërtimin e komunitetit;
   b) numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit;

c) adresën e selisë dhe të dhënat e kontaktit;

ç) numrin e anëtarëve;

d) të dhënat mbi njësitë prodhuese dhe depozituese të përfshira në KER dhe kapacitetin e secilës prej tyre, si dhe kapacitetin total të KER-it;

dh) statusin e regjistrimit (aktiv/pezulluar);

e) datën e pezullimit dhe, sipas rastit, datën e rikthimit të statusit aktiv.

3. ERE përditëson të dhënat e Regjistrit në bazë të vendimeve të Bordit, njoftimeve të KER-it dhe informacionit të administruar në përputhje me këtë rregullore.
4. Të dhënat personale, informacioni konfidencial tregtar dhe të dhënat e tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë objekt publikimi, nuk bëhen publike në Regjistër.
5. Publikimi i të dhënave sipas këtij neni bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e informimit dhe ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit.

Neni 10
Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve

1. KER është e detyruar të njoftojë ERE për çdo ndryshim në të dhënat e deklaruara gjatë procesit të regjistrimit, përfshirë:
   a) strukturën organizative;
   b) përbërjen e anëtarësisë;
   c) administratorin ose përfaqësuesin ligjor;
   ç) njësitë prodhuese të përfshira në KER dhe kapacitetet e tyre;
   d) të dhënat e kontaktit.
2. Njoftimi paraqitet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit.
3. Kur ndryshimet e përcaktuara në pikën 1 mund të ndikojnë në përmbushjen e kushteve të zbatueshme për KER-in, njoftimi shoqërohet me dokumentacionin që provon vijimin e përmbushjes së këtyre kushteve.
4. Kur nga shqyrtimi i ndryshimeve rezulton se KER nuk përmbush më kushtet e zbatueshme për funksionimin e tij, ERE vepron në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje për pezullimin e statusit.
5. ERE shqyrton ndryshimet e njoftuara dhe përditëson të dhënat e Regjistrit, kur është e nevojshme.

Neni 11
Ruajtja e kushteve të regjistrimit

1. KER është i detyruar të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë gjithë periudhës së regjistrimit, kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme.
2. KER mban dhe administron dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për të provuar vijimin e përmbushjes së kushteve të regjistrimit dhe e vë atë në dispozicion të ERE-së, sipas kërkesës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12
Rastet e pezullimit

ERE mund të vendosë pezullimin e statusit aktiv të një KER kur:

a) konstatohet se nuk plotësohen më kriteret ligjore për regjistrim;

b) KER nuk përmbush detyrimet për raportim ose dorëzim informacioni;

c) paraqiten të dhëna të pasakta, të paplota ose të pavërteta;

ç) pengohet procesi i verifikimit ose kontrollit të ushtruar nga ERE;

d) shkel rregullat e tregut dhe Kodet e Rrjetit;

dh) konstatohen shkelje të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi ose në këtë rregullore.

Neni 13
Procedura e pezullimit

1. Përpara marrjes së vendimit për pezullim, ERE njofton KER për shkaqet dhe faktet që kanë sjellë fillimin e procedurës.
2. KER i jepet një afat jo më pak se 7 ditë kalendarike për paraqitjen e shpjegimeve ose korrigjimin e mangësive të konstatuara.
3. Nëse mangësitë nuk korrigjohen brenda afatit të përcaktuar, Bordi i ERE vendos për pezullimin e statusit aktiv të KER dhe KER merr masat e nevojshme për rikthimin e kushteve të regjistrimit dhe njofton ERE-n për përmbushjen e tyre, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.

Neni 14
Pasojat e pezullimit

1. Gjatë periudhës së pezullimit:
   a) statusi i KER në regjistër ndryshohet në “pezulluar”;
   b) KER nuk mund të ushtrojë të drejtat ose të përfitojë nga mekanizmat që kërkojnë status aktiv regjistrimi, Gjatë periudhës së pezullimit, KER nuk mund të ushtrojë të drejtat ose

të përfitojë nga mekanizmat që, sipas legjislacionit në fuqi, kushtëzohen nga statusi aktiv i regjistrimit.

Neni 15
Rikthimi i statusit aktiv

1. Pas eliminimit të shkaqeve që kanë sjellë pezullimin, KER paraqet kërkesë pranë ERE për rikthimin e statusit aktiv.
2. ERE shqyrton kërkesën brenda 15 ditëve pune nga data e paraqitjes së saj.
3. Në rast se vlerësohet se janë përmbushur kërkesat përkatëse, ERE shprehet me vendim dhe ndryshon statusin e KER në "aktiv".

Neni 16
Heqja nga Regjistri

1. Në rast se, pas komunikimit të vendimit për pezullimin e statusit, KER nuk rikthen kushtet e regjistrimit, ERE fillon procedurën për heqjen e tij nga Regjistri i Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
2. ERE njofton KER-in për heqjen nga Regjistri të paktën 3 (tre) ditë pune përpara marrjes së vendimit.
3. Nëse KER nuk provon rikthimin e kushteve të regjistrimit, Bordi i ERE-së vendos heqjen e tij nga Regjistri i Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
4. Vendimi për heqjen nga Regjistri i njoftohet KER-it dhe pasqyrohet në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.

Neni 17
Ankimimi

Kundër vendimeve të Bordit të ERE-së të marra në zbatim të kësaj rregulloreje mund të ushtrohet ankim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18
Kontrolli dhe monitorimi

ERE ushtron kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje nëpërmjet:

a) shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga KER;

b) verifikimeve administrative;

c) kërkesave për informacion shtesë dhe shkëmbimit të informacionit me operatorët e sistemit dhe subjektet e tjera kompetente, për çështjet që lidhen me lidhjen, përdorimin e rrjetit, matjen, operimin dhe respektimin e kodeve të rrjetit;

ç) çdo mjeti tjetër të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

Neni 19
Raportimi periodik

1. KER-i, brenda datës 31 janar të çdo viti, raporton pranë ERE-së të dhënat dhe informacionin për vitin paraardhës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 4, datë 29.06.2026 "Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme".
2. Të dhënat dhe informacioni i raportuar duhet të jenë të plotë, të saktë dhe të përditësuar.
3. ERE mund t'i kërkojë KER-it sqarime ose plotësimin e informacionit të raportuar, kur kjo është e nevojshme për verifikimin e përmbushjes së kërkesave të legjislacionit në fuqi.
4. ERE publikon në mënyrë të agreguar të dhënat e raportuara nga KER-et, në përputhje me Udhëzimin nr. 4, datë 29.06.2026 "Për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme", duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit konfidencial.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE-s dhe publikimit në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

ANEKSI 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMUNITETIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (KER)

Në zbatim të nenit 5, pika 2, të Rregullores për regjistrimin dhe administrimin e regjistrit të KER-ve.

I. TË DHËNAT E KER-IT

Emërtimi dhe forma juridike: _____

Numri unik i identifikimit (NIPT/NUIS): _____

Adresa e selisë: _____

E-mail / telefon: _____

Përfaqësuesi ligjor: _____

II. VEPRIMTARITË E PLANIFIKUARA

☐ Prodhim ☐ Konsum ☐ Depozitim ☐ Ndarje energjie ☐ Shitje ☐ Agregim ☐ Tjetër

Përshkrim i shkurtër i veprimtarisë: _____

_____

III. ANËTARËT THEMELUES

Numri i anëtarëve: _____ Lista e anëtarëve themelues: ☐ Bashkëlidhur

IV. IMPIANTET DHE PAJISJET

Lloji i centralit / burimi i energjisë: _____

Kapaciteti i instaluar ose i planifikuar (kW): _____ Vendndodhja: _____

Përshkrimi i centralit dhe pajisjeve të instaluara/të planifikuara: _____

_____

V. DEKLARIMI

Deklaroj se KER-i përmbush kriteret dhe kërkesat ligjore për funksionimin e tij dhe se të dhënat e paraqitura janë të sakta e të plota.

Deklaratat e anëtarëve sipas Aneksit 2: ☐ Bashkëlidhur

Dokumentacioni shoqërues sipas nenit 6 të rregullores: ☐ Bashkëlidhur

Data: ____/____/_____ Përfaqësuesi ligjor: _____

Nënshkrimi: _____

ANEKSI 2

DEKLARATË E ANËTARIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME

Në zbatim të nenit 5, pika 3, shkronja "f", të rregullores për regjistrimin e KER-ve.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nr. identifikimi/NIPT _____, në cilësinë e anëtarit/përfaqësuesit të personit juridik _____, deklaroj se:

1. Anëtarësohem vullnetarisht në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme _____.
2. Jam njohur me statutin, qëllimin e veprimtarisë dhe të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi.
3. Përmbush kriteret ligjore të anëtarësimit dhe të dhënat e deklaruara janë të sakta.
4. Angazhohem të njoftoj KER-in për çdo ndryshim që ndikon në kushtet e anëtarësimit.

Vendi dhe data: _____

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi: _____